



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2062/2 prot

Datë 25.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-08245-06-05-2024, me objekt: Loti 3 “*Skaner dhe MRZ Reader*”, me fond limit 7,550,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.06.2024, nga autoriteti kontraktor Identitek SHA.

Ankimues: Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK me NIPT (J61817047D) dhe adresë: Bulevardi “Zhan D’ark”, Nd.32, Hyrja 16, kati 2, Ap.1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Identitek SHA, me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Tiranë

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4368, datë 24.07.2024 dhe nr. Protokoll 2062/2024, datë 24.07.2024, të operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-08245-06-05-2024, me objekt: Loti 3 “*Skaner dhe MRZ Reader*”, me fond limit 7,550,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.06.2024, nga autoriteti kontraktor Identitek SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK kundërshton me anë të ankesës nr. A/2024/4368, datë 24.07.2024 dhe nr. Protokollit 2062/2024, datë 24.07.2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

Në lidhje me specifikimet teknike të pajisjeve / artikujve, të paraqitur me katalogët përkatës, konstatohen mangësitë / mosplotësimet e mëposhtme:

SKANER

- Modeli i paraqitur, referuar katalogut, nuk ofrohet me ushqim “poëer supply”: USB, sic është kërkuar, por me “AC Poëer:

24V / 0.75A” duke mos plotësuar këtë kërkesë teknike të produktit.

Sa më sipër, për arsye të mospërmbushjes së specifikimeve teknike si rrjedhojë e konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo oferte refuzohet.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 25.07.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri